



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 83, datë 16.02.2023

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}, DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË
EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONIN E LIRË TË
SHPLLUR ME VENDIMIN NR. 178, DATË 11.05.2022, TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 16.02.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës, të kandidatit për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Dritan Hallunaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale...”

2. Në shpalljen e vendimit, afati i kandidimit është përcaktuar “*deri më datë 01.06.2022*”.

3. Vendimi i Këshillit si më lart është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 11.05.2022, duke filluar të ecin afatet e kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 12.05.2022.

4. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, ka kandiduar edhe gjyqtari z. {...} (më poshtë referuar si kandidati).

5. Me vendimin nr. 220, datë 20.06.2022, Këshilli vendosi: *“Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, dhe Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 1. Për kandidatin z. {...} - relator z. Dritan Hallunaj; ...”.*

6. Më datë 20.06.2022, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019 *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”,* (i azhurnuar) (më poshtë referuar si vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Më datë 22.06.2022, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, i ndryshuar) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

9. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, i ndryshuar, kandidati duhet ta dorëzonte, jo më vonë se 31 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 17.07.2022, pranë ILDKPKI-së.

10. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 29.06.2022, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019 (i ndryshuar), përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}.

11. Sipas pikës 9, të vendimit të Këshillit nr.178, datë 17.11.2021, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”.* Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që janë kriteri i *“përvojës profesionale minimale”, i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe i “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale,* me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidatin z. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga institucionet kompetente.

12. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, Këshilli, me vendimin nr. 366, datë 13.09.2022, ka vendosur:

1. *Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*
2. *Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.*

13. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur kandidati është subjekt rivlerësimi “ex officio” sipas ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që për kandidatin nuk kishte përfunduar, referuar nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli me shkresën nr. 3728 prot., datë 30.06.2022 i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatit. Gjithashtu, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS

14. Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcakton se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

15. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera edhe në Gjykatën e Lartë, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, në vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019) i ndryshuar. Patur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “ex officio”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidojnë për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

16. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, të cilët janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për periudhën e rivlerësimit kalimtar, vendimi i Këshillit mbështetet në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit. 2. Për kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, për të cilët nuk ka filluar ose nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon shqyrtimin me përparësi të këtij procesi ndaj tyre. Për këta kandidatë fillon verifikimi i pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Procedura e verifikimit përmbyllet mbas dhe në varësi të mënyrës së përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar. 3. Marrja e masës disiplinore sipas neneve 60 dhe 61, të Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përbën shkak për skualifikimin dhe përjashtimin nga procedurat e ngritjes në detyrë të kandidatëve subjekt rivlerësimi kalimtar”.*

17. Sa më sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidatit i cili i është nënshtrohet dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. Në kuadër të verifikimit të figurës, ky kandidat i nënshtrohet verifikimit të integritetit sipas ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në kushtet kur ai është i vitlindjes para Korrik 1977 (kandidati është i vitlindjes janar 1972), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019, i ndryshuar.

18. Rezulton se kandidati, z. {...} i është nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me vendimin nr. 588, datë 22.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat u shtri për periudhën 28.1.2017 deri më datë 18.07.2022.

A. Për kriterin e pasurisë

19. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32¹, të Ligjit për Statusin (i ndryshuar), për periudhën pas dhënies së vendimit për verifikimin nga organet e rivlerësimit kalimtar.

¹ “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse

20. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 823/25 prot., datë 10.01.2023.

20.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati z. {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

20.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati z. {...}, për periudhën pas dhënies së vendimit nga ana e organeve të rivlerësimit, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

21. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

21.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, konkretisht Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës informacioni u dërgua me shkresën nr. 5749/1 prot., datë 14.07.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3708/8 prot., datë 18.07.2022, ku për kandidatin z. {...} nuk jepet ndonjë e dhënë që të jetë i regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat. Rezulton se ky shtetas është i regjistruar si individ privat për përgjegjësinë tatimore Deklarim Individual Vjetor i të

është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.

5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...".

Ardhurave (DIVA). Nga ana e shtetasit {...} është dorëzuar deklarata individuale vjetore për periudhat janar-dhjetor 2019, janar-dhjetor 2020 dhe janar-dhjetor 2021.

21.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me shkresën nr. 12442/1 prot., datë 08.07.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3708/7 prot., datë 12.07.2022, ku për kandidatin z. {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

23. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidatin, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

24. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

25. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

B. Për kriterin e figurës

26. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin (i ndryshuar), për periudhën pas dhënies së vendimit për verifikimin nga organet e rivlerësimit.

27. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u verifikua dhe u vërtetuan të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit z. {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

28. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin z. {...}, në kushtet kur ky kandidat ka qenë magjistrat në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidati i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

29. Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me shkresën nr. 3587/1 prot., datë 27.06.2022, ku për kandidatin z. {...} është bërë me dije se: - ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 29.04.2016; nga struktura e posaçme ka marrë numër rendor 000309; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të ëëb; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore me shkresën nr. 3862/1 prot., datë 06.06.2016 personi rezulton (i padënuar) nga gjykatat penale shqiptare dhe zyra e gjendjes civile me shkresën nr. 3440/4 prot., datë 08.02.2017, personi rezulton të mos ketë ndryshime në përbërësit e gjëndjes civile: - deri më sot nuk ka pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

30. Kandidati iu nënshtrua verifikimit të integritetit sipas ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në kushtet kur ai është i vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidati është i vitlindjes janar 1972), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019. Përmes shkresës nr. 1157/2 prot., datë 22.07.2022, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. 3776/1 prot., datë 22.07.2022 nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, u dërgua bashkëlidhur vendimi nr. 319, datë 21.07.2022. Sipas këtij vendimi rezulton se *kandidati z. {...} nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; nuk ka qenë bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish Sigurimi i Shtetit; nuk ka qenë anëtar i ish sigurimit të shtetit, deri në 2 korrik 1991, sipas përcaktimeve të nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015.*

31. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;

- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e kandidatit, mbi të cilat mund të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

III. KONKLUZIONE

32. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019 (i ndryshuar), nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

33. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022.
2. Vendimi nr. 366, datë 13.09.2022, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR